

UDHËZIM
Nr.6 datë 17.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 6257, DATË 2.9.2008 “MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, të ndryshuar dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas germës “a” të pikës 7/1, shtohet germa a/a me këtë përmbajtje:

“a/a. Asnjë anëtar i familjes që përfiton kredi të lehtësuar, të mos jetë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar”.

2. Pas pikës 7/6, shtohet pika 7/7 me këtë përmbajtje:

“7/7 Banka nuk lidh kontratë, nëse qytetari përfitues i kredisë me interes 0%, nuk dorëzon një deklaratë noteriale që ai dhe familja e tij pranojnë të lirojnë banesën e pronarit brenda 30 ditëve nga data e livrimit të kredisë, përveç rasteve kur ka marrëveshje noteriale me pronarin/pronarët.

3. Pika 19 ndryshon si më poshtë:

“Enti Kombëtar i Banesave ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e programit, bazuar në kontratat e lidhura mes bankës dhe familjeve, si dhe bën verifikimet e nevojshme në të gjitha institucionet publike e private, qendrore e vendore, të ngarkuara për lëshimin e dokumenteve sipas këtij udhëzimi. Për këtë, një kopje e kontratës së kreditimit dhe e dokumentacionit që shoqëron çdo kontratë, i dërgohet Entit Kombëtar të Banesave nga banka. Për këtë shërbim, EKB-ja përfiton 1% të fondit të subvencionit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve operative. Kjo shumë mbahet mbi çdo disbursim të subvencionit që EKB-ja i bën bankës, sipas pikës 18.”.

4. Pas pikës 19, shtohen pikat 19/1 dhe 19/2 me këtë përmbajtje:

“19/1. EKB-ja njofton bankën për ndërprerjen e subvencionit, kur nga verifikimet që kryen EKB-ja në mënyrë rastësore ose specifike, bazuar në ankesa apo denoncime të individëve a institucioneve, konstatohen:

a) se qytetari nuk ka liruar banesën e pronarit brenda afatit të përcaktuar në pikën 7/6 të këtij udhëzimi;

b) falsifikime të dokumenteve apo deklarata të rreme;

c) mospërmbushje e të gjitha kushteve të parashikuara në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008, të ndryshuar, nga ana e bankës së përzgjedhur për dhënien e kredisë.

19/2 Çështjet “a” dhe “b” të pikës 19/1, të jenë pjesë e kontratës që lidh banka me subjektet përfituese, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.”.

5. Pas pikës 21, shtohen pikat 21/1, 21/2, 21/3 e 21/4, me këtë përmbajtje:

“21/1. Të gjitha institucionet shtetërore, të cilat kanë miratuar listën e përfituesve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, dorëzojnë pranë EKB-së listën emërore të përfituesve dhe kopjen e plotë të dokumentacionit të dorëzuar nga nëpunësi pranë institucionit përkatës konform vendimit të sipërcituar. Në mungesë të këtij dokumentacioni, EKB-ja nuk procedon me rimbursimin e subvencionit për këto subjekte.

21/2. Kontrata nuk lidhet edhe në rastet kur konstatohet se subjektet përfituese nga njëri

prej nënprogrameve të kreditimit të lehtësuar, kanë përfituar nga programe shtetërore të mëparshme strehimi.

21/3. Banka akordon kredinë për subjektin që ka përfituar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 vetëm për blerje banese në qytetin ku subjekti ushtron veprimtarinë për të cilën ka përfituar të drejtën e subvencionimit.

21/4. Nëse subjekti përfitues figuron në disa lista, ai mund të përfitojë vetëm nga njëri prej 3 nënprogrameve të kreditimit të lehtësuar, sipas përzgjedhjes së tij/saj.”.

6. Pas pikës 22, shtohen pikat 23, 24, 25 e 26, respektivisht me këtë përmbajtje:

“23. Kontrata e kreditimit lidhet mes bankës dhe të gjithë pjesëtarëve madhorë të familjes.

24. Për lidhjen e kontratës me bankën, familjet, emrat e të cilëve janë miratuar me vendim të këshillave bashkiakë dhe i janë dërguar bankës, kanë një afat prej 6 (gjashtë) muaj nga data e njoftimit zyrtar që bashkia i bën të interesuarit. Skadenca e këtij afati fillon me datën e protokollimit të korrespondencës së dërguar nga bashkia EKB-së. Në rast se pas kalimit të këtij afati, familja ende nuk ka gjetur banesë, paraqitet pranë EKB-së për të kërkuar shtyrje të afatit.

25. Në rast se familja nuk paraqitet brenda 6 muajve, veprohet sipas rasteve më poshtë:

a) Kur nga bashkitë janë dërguar lista rezervë, banka në rakordim me EKB-në vijon me listën emërore rezervë.

b) Kur lista rezervë është shteruar, EKB-ja njofton bashkinë përkatëse për dërgimin e emrit/emrave të tjerë sipas kuotës që përfiton bashkia.

26. Kur familja paraqitet brenda 6 muajve pranë EKB-së, duke kërkuar shtyrje të afatit, emri i subjektit vazhdon të qëndrojë në listë pritjeje edhe për 6 muaj të tjerë. Më pas, EKB-ja njofton bashkinë sipas rasteve më sipër.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT Sokol Olldashi	MINISTRI I FINANCAVE Ridvan Bode
---	--